



REPUBLIKA E SHqipëRISE
MINISTRIA E FINANCAVE

Dhjetor 2017

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Dhjetor 2017

© Ministria e Financave, 2017

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: vivi.besho@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Dhjetor 2017 arriti në 104.01 për qind;*
- *Norma vjetore e inflacionit për muajin Dhjetor 2017 ishte 1.8 për qind;*
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Dhjetor 2017 ishte 112.56 lekë për dollarë dhe 133.25 lekë për euro;*
- *Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Dhjetor 2017 shënuan kuotën 0.80 për qind për ato 12 –mujore; 0.56 për qind për depozitat 6-mujore; 0.29 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.82 për qind për depozitat 1-mujore;*
- *Normat e interesit për huatë në lekë ishin 6.79 për qind për huatë 12-mujore dhe 8.12 për ato 6-mujore;*
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,266,909 milionë lekë në muajin Dhjetor, duke shënuar një rritje prej rreth 0.3 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;*
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të 2017-ës shënoi rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 37.6 milionë euro.*
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar-Dhjetor 2017 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 31.0 miliardë lekë, ndërkohë që deficitin ishte planifikuar 31.2 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017, arritën në rreth 430.3 miliardë lekë ose afërsisht 97 % e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 461.4 miliardë lekë ose 97 % e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*

Zhvillimet Ekonomike


1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Dhjetor 2017 ishte +1.8%. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +2.2%.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Dhjetor 2017 shënoi rritje prej 1.0 për qind krahasuar me muajin paraardhës, ndërsa në muajin Nëntor pati rënie prej 0.1 për qind. Gjithashtu përgjatë muajit tetor, indeksi ka shënuar rritje prej 0.04 për qind në krahasim me muajin paraardhës përkatës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Dhjetor 2016 shënoi rritje 0.9 për qind në krahasim me muajin paraardhës.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin: “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me një rritje vjetore të çmimit prej +2.8%, duke kontribuar me +1.13 pikë përqindje; “Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me një rritje vjetore të çmimit prej +2.2%, duke kontribuar me +0.44 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.8%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit nuk ka pasur



kategori të cilat kanë ndikuar negativisht në inflacionin e përgjithshëm përgjatë muajit nëntor 2017.

Ndryshimi mujor i indeksit është +1.0%. Krahasuar me muajin Nëntor 2017 rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 1,8%, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 1,3%, grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1,0%. Çmimet e grupeve “Transporti” dhe “Shëndeti” shënuan një ulje prej 0,1% secili.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2016	1.5	0.2	0.3	0.3	0.7	1.2	1.9	2.0	1.8	1.5	1.9	2.2
2017	2.8	2.2	2.1	1.9	2.0	2.2	2.0	1.6	1.6	1.9	1.7	1.8


Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Dhjetor 2017, arriti në 133.25 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 0.18 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Dhjetor, një euro u këmbye me 132.95 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Dhjetor 2017 arriti në 112.56 lekë/dollarë duke shënuar rënie në vlerë me 1.27 për qind kundrejt muajit Nëntor 2017. Në fund të muajit Dhjetor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 111.1 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Dhjetor të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 1.49 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 12.26 për qind. Forcimi i lekut në dy vitet e fundit është nxitur nga përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend, pritjet për vazhdimin e kësaj tendence në të ardhmen dhe reduktimi i primit të rrezikut për ekonominë tonë.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.84 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave



Gjatë muajit Dhjetor 2017, normat e interesit të depozitave me afat 1 mujor shënuan vlerën më të lartë prej 0.82 për qind, pasuar nga ato me afat 12 dhe 6-mujore që arritën përkatësisht kuotën 0.80 dhe 0.56 për qind. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 3 mujore arritën kuotën 0.29 për qind.

Normat e interesit të depozitave 6 dhe 1-mujore kanë shënuar rënie mujore me nga 0.05 pikë përqindje. Ndërsa rritje mujore kanë shënuar normat e interesit të depozitave 12 dhe 3 mujore prej përkatësisht 0.06 dhe 0.03 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë shënuar normat e interesit të depozitave me afat maturimi 6 dhe 1-mujore me përkatësisht 0.22 dhe 0.05 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 3-mujore kanë shënuar rritje me nga 0.02 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12-mujore gjatë muajit Dhjetor 2017 arritën përkatësisht kuotën prej 8.12 dhe 6.79 për qind. Normat e interesit të huave 6 dhe 12-mujore kanë shënuar rritje mujore respektivisht prej 0.39 për qind, dhe 0.79 për qind. Gjithashtu, krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12-mujore kanë shënuar rritje prej 1.11 për qind dhe 2.25 për qind.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Dhjetor 2017 arritën nivelin 2.63 për qind duke shënuar kështu rritje mujore prej 0.09 për qind dhe rënie vjetore prej 0.29 për qind.





4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e dytë të vitit 2017 shënoi rritje të mjeteve valutore, me rreth 37.7 milionë euro. Tremujori i tretë i 2017-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 132.9 milionë euro, dhe vlerësohet në rënie me bazë vjetore (rreth 10%). Deficiti tregtar ra me rreth 13%, në nivelin 374 milionë euro. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 103 milionë euro në rënie me 43 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Flukset e kapitalit, shumat e tepricave nën zërin “Llogaria kapitale” dhe “Llogaria financiare”, regjistruan një pozicion neto negativ prej rreth 238.9 milionë euro. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Gjatë periudhës transaksionet në llogarinë korrente vlerësohen rreth 3,015 milionë euro dhe janë zgjeruar me 12% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente shënon 133 milionë euro, rreth 10% më i ulët krahasuar me një vit më parë. Tkurrja e deficitit korrent, këtë tremujor, u diktua nga zgjerimi i ndjeshëm në suficitin e llogarisë së shërbimeve. Ky zhvillim u mbështet nga flukset e larta hyrëse në “shërbime të tjera biznesi” si dhe në “shërbime udhëtimi”. Kompozicioni deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesore përbërës (në terma neto) për tremujorin e parë 2017 (Fig-6):


- (i) bilanci tregtar me -753.8 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 380.2 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me 28.5 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 212.2 milionë euro.



5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar


Gjatë muajit Dhjetor 2017, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 3,571 milionë lekë krahasuar me muajin Dhjetor të vitit 2016. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 2,496 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 5,344 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 22,482 milionë lekë të bankave të nivelit të dytë, duke u kompensuar nga rritja prej 17,138 milionë lekë e Bankës Qendrore.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1,266,907 milionë lekë në muajin Dhjetor 2017, duke shënuar rritje prej rreth 3,453 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 0.3 për qind.

Në muajin Dhjetor 2017, sistemi bankar rezulton me rritje prej 13,875 milionë lekë ose +1.1 për qind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Dhjetor 2017 arriti në rreth 550,280 milionë lekë. Balanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 2,678 milionë lekë, ose rritje prej rreth 0.49 për qind. Struktura e kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 50.3 për qind të totalit të tepriçës së kredisë me rreth 277,022 milionë lekë.

Gjatë muajit Dhjetor 2017, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 60.8 për qind ose 334,763 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 32,21 për qind ose 177,270 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 5.36 dhe 1.44 për qind apo 29,515 dhe 7,945 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin Dhjetor 2017, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 49.8 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 39.6 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 71.7 për qind dhe rreth 24.8 për qind.



7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 265,156 milionë lekë në fund të muajit Dhjetor 2017. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Dhjetor 2017 ka shënuar rritje mujore prej 0.57 për qind si dhe rritje vjetore prej 1.20 për qind, duke arritur nivelin 20.9 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rritje mujore prej 0.91 për qind dhe rritje vjetore prej 1.89 për qind, duke shënuar nivelin 26.5 për qind.

Fig-11




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Dhjetor 2017, kanë pësuar rritje prej 1,497 milionë lekë, mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 81.9 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa depozitat në Lekë gjatë muajit Dhjetor 2017 shënuan rënie prej 13,943 milionë lekë në krahasim me muajin Dhjetor 2016. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 83.0 për qind të tyre.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Dhjetor 2017, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 83.0 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 12.3 për qind dhe nga “Korporata të tjera financiare” me 2.5 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 81.9 për qind dhe rreth 16.0 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 82.4 për qind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 825,832 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (142,526 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (18,900 milionë lekë) dhe “Korporata jofinanciare publike” (12,992 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1,499 milionë lekë në totalin e depozitave.

Fig-14



Përberja e depozitave Dhjetor 2017

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit Dhjetor 2017, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,001,751 miliardë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 3,787 milionë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rënie me 12,446 milionë lekë.


Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar-Dhjetor 2017 janë mbledhur rreth 430.3 miliardë lekë të ardhura, përkundërt shpenzimeve të përgjithshme prej 461.4 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 382.2 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 68.4 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 67% janë financime të brendshme.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 293.3 miliardë lekë (ose rreth 98% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushtetit vendor rreth 18.4 miliardë lekë (ose rreth 88% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 85.6 miliardë lekë (ose rreth 102% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 20.6 miliardë lekë (ose rreth 85% e planit të periudhës Janar-Dhjetor 2017).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 382.2 miliardë lekë, 72.6 miliardë lekë (19% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 31.9 miliardë lekë (10%) për shpenzime interesi, 43.4 miliardë lekë (11%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje,



2.3 miliardë lekë (1.0%) për subvencione, 158.1 miliardë lekë (40%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 46.4 miliardë lekë (12%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 23.3 miliardë lekë (6%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 98% (shpenzime personeli), 84% (shpenzime për interesat), 96% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 98% (subvencione), 100% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 99% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 99% (shpenzimet e tjera) përkundërt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 95%, ndërsa financimi i huaj është 91% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Dhjetor 2017 ishin rreth 430.3 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 398.6 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 20.6 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017 (mld Lekë) Revenues during January-December 2017 (in billion ALL)		
Burimi (Source)	Dhjetor '17 December '17	Dhjetor '16 December'16	Ndrysh(%) Chang (%)
TVSH (VAT)	139.5	131.3	5.3
Taksa doganore (Custom Tax)	6.4	6.1	5.8
Akczizat (Excise)	45.1	41.8	7.7
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	27.6	29.1	8.6
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	32.1	31.4	2.2
Taksat nacionale (National Tax)	36.1	32.9	9.6

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Dhjetor – 2017

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: December – 2017

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 31.0 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017, u mbështet në vlerën 29.1 miliardë lekë nga financime të jashtme.

Për muajin Dhjetor 2017, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 39.953 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 61.932 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Dhjetor 2017, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat arrijnë shifrën e 35.7 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 40.8 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 17.0 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2013	2014	2015	2016	2017	2013	2014	2015	2016	2017	2013	2014	2015	2016	2017	
Janar	1.0	0.8	1.4	0.9	1.5	1.00	0.8	1.4	0.9	0.9	2.7	1.7	1.3	1.5	2.8	January
Shkurt	1.1	1.4	2.4	1.1	0.5	1.05	1.1	1.9	1.0	1.0	2.5	1.9	2.3	0.2	2.2	February
Mars	0.2	0.5	0.4	0.5	0.4	0.77	0.9	1.4	0.8	0.8	2.4	2.2	2.2	0.3	2.1	March
Prill	-0.1	-0.6	-0.5	-0.4	-0.6	0.55	0.5	0.9	0.5	0.7	2.3	1.7	2.3	0.3	1.9	April
Maj	-1.0	-1.1	-1.6	-1.2	-1.2	0.24	0.2	0.3	0.2	0.1	2.1	1.6	1.8	0.7	2.0	May
Qershor	-0.6	-0.7	-1.1	-0.6	-0.4	0.15	0.1	0.1	0.04	0.0	2.3	1.5	1.4	1.2	2.2	June
Korrik	-0.8	-0.6	-0.7	0.05	-0.1	-0.03	0.0	0.1	0.20	0.3	1.6	1.8	1.3	1.9	2.0	July
Gusht	-0.1	0.1	0.8	0.86	0.4	-0.04	0.0	0.1	0.21	0.1	1.2	2.0	1.9	2.0	1.6	August
Shtator	0.8	0.3	0.6	0.40	0.4	0.06	0.0	0.2	0.17	0.3	1.7	1.5	2.2	1.8	1.6	September
Tetor	0.1	0.1	0.01	-0.2	0.04	0.05	0.0	0.2	0.13	0.1	1.7	1.4	2.1	1.5	1.9	October
Nëntor	-0.5	-0.2	-0.3	0.1	-0.1	0.01	0.0	0.1	0.12	0.1	1.0	1.7	2.1	1.9	1.7	November
Dhjetor	1.7	0.7	0.6	0.9	1.0	0.15	0.1	0.17	0.19	0.2	1.9	0.7	2.0	2.2	1.8	December

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2014	2015	2016	2017												Currency
				Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
				January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	December	
<i>Mesatarja e periudhës</i>																<i>Average of period</i>
USD	113.64	126.64	128.29	128.40	127.43	126.74	126.33	121.83	118.59	115.24	112.23	112.10	113.74	114.01	112.56	USD
EURO	140.11	137.65	135.27	136.57	135.59	135.38	135.42	134.58	133.21	132.57	132.53	133.55	133.66	133.49	133.25	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>																<i>In the end of period</i>
USD	115.23	125.79	128.17	127.37	127.45	127.34	123.55	119.99	116.30	113.39	112.29	113.37	114.71	112.97	111.10	USD
EURO	140.14	137.28	135.23	136.39	135.08	136.13	135.03	134.19	132.59	132.98	133.50	133.70	133.42	113.64	132.95	EURO

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2014	2015	2016	2017												In percent	
				Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	Nëntor November	Dhjetor December		
Norma e depozitave																	Deposits rates
12-M	1.51	1.27	0.78	0.69	0.94	0.90	0.81	0.75	0.77	0.69	0.56	0.74	0.81	0.74	0.80	0.80	12-M
6-M	1.16	1.17	0.78	0.57	0.78	0.58	0.53	0.72	0.80	0.49	0.81	0.69	0.54	0.61	0.56	0.56	6-M
3-M	0.83	0.54	0.27	0.31	0.27	0.28	0.25	0.27	0.28	0.24	0.26	0.34	0.30	0.26	0.29	0.29	3-M
1-M	1.47	0.88	0.87	0.86	0.68	0.97	0.97	1.01	0.96	0.92	0.75	0.68	0.77	0.87	0.82	0.82	1-M
Norma e huasë																	Lending rates
12-M	7.00	7.47	4.54	6.27	6.87	6.71	3.89	5.51	6.36	7.06	6.02	6.51	6.65	6.00	6.79	6.79	12-M
6-M	8.18	8.35	7.01	9.74	8.60	8.44	6.55	7.56	10.55	8.22	9.24	6.52	7.39	7.73	8.12	8.12	6-M
Norma e letrave me vlerë																	Securities rates
Bono thesari 1/																	Treasury bills 1/
3-M	3.15	-	-	1.22	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3-M
6-M	3.16	2.46	2.00	2.25	2.01	1.70	1.52	1.54	-	1.54	1.65	-	1.82	2.04	-	-	6-M
12-M	3.33	2.40	2.92	3.20	2.93	2.25	1.79	1.98	2.04	2.12	2.20	2.31	2.46	2.54	2.63	2.63	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 4 TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2017

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2017

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (In million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	Nëntor November	Dhjetor December	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	32,894	64,045	101,547	140,280	176,742	212,285	248,610	284,875	320,071	356,375	390,445	430,397	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	186	644	1,415	1,933	2,777	3,592	4,087	5,051	5,607	7,096	8,384	11,085	Grants
II.	Të ardhura tatimore	30,935	59,658	94,497	129,801	163,384	196,177	230,753	264,724	298,042	331,392	362,857	398,629	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	22,021	42,805	69,994	93,351	118,724	143,261	168,348	193,769	218,606	242,485	266,240	293,386	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,145	20,236	31,302	41,917	53,745	65,757	78,284	89,798	101,921	114,448	125,954	139,541	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,620	3,827	11,177	13,447	15,326	17,399	19,291	21,069	23,465	25,336	27,631	31,645	Profit Tax
3	Akçizat	2,727	5,730	9,241	12,928	16,779	21,165	25,336	30,194	33,921	37,447	41,433	45,105	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,185	5,414	7,663	10,373	12,914	15,605	18,581	21,992	24,528	27,016	29,504	32,102	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,930	6,734	9,252	12,845	17,484	20,300	23,205	26,449	29,998	32,908	35,819	38,502	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	414	864	1,359	1,841	2,476	3,035	3,650	4,267	4,774	5,330	5,900	6,492	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	907	2,398	3,812	7,815	9,288	10,872	12,026	13,676	15,355	16,270	17,220	18,447	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	195	410	775	2,133	2,536	3,026	3,345	3,676	4,010	4,265	4,534	4,879	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	2	8	31	204	220	234	246	251	262	272	283	296	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	710	1,980	3,006	5,478	6,532	7,611	8,435	9,749	11,083	11,734	12,403	13,273	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	8,007	14,455	20,691	28,635	35,372	42,045	50,379	57,278	64,800	72,637	79,397	86,795	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	6,743	12,238	17,537	24,221	29,946	35,657	42,723	48,675	54,518	61,768	67,589	73,999	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,146	1,970	2,780	3,922	4,779	5,651	6,847	7,718	8,596	9,809	10,690	11,602	Health insurance
III.	Të ardhura Jotatimore	1,773	3,742	5,636	8,547	10,580	12,516	13,769	15,101	16,422	17,887	19,204	20,683	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë				908	908	908	908	908	908	908	908	908	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,320	2,901	4,098	5,211	6,781	8,262	9,213	10,052	10,969	11,878	12,797	13,694	Income of budgetary institutions
	TOTALI I SHPENZIMEVE	25,634	55,791	95,189	129,825	170,448	209,595	247,392	284,982	322,603	359,883	399,478	461,410	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	24,639	52,626	84,730	113,906	146,783	180,493	213,420	245,871	276,639	308,556	341,409	382,287	Current Expenditures
I.1	Personell	5,475	10,992	16,585	22,606	28,716	34,981	41,341	47,619	53,831	60,033	66,227	72,642	Personnel expenditures
1	Paga	4,700	9,451	14,257	19,446	24,696	30,105	35,601	41,022	46,386	51,744	57,071	62,581	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	776	1,541	2,328	3,160	4,020	4,876	5,740	6,597	7,445	8,290	9,156	10,061	Social insurance contributions
I.2	Interesat	2,829	5,569	7,823	9,795	12,145	14,290	17,007	19,613	21,612	24,122	29,621	31,904	Interest
1	Të Brendshme	2,078	4,190	5,909	7,291	9,142	10,731	12,706	14,681	16,323	18,110	19,679	21,415	Domestic
2	Të Huaja	752	1,380	1,914	2,504	3,003	3,559	4,301	4,933	5,289	6,011	9,942	10,489	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,567	4,503	8,631	11,106	14,580	18,273	21,916	24,679	27,886	32,044	35,461	43,441	Operational & Maintenance
I.4	Subveclonet	55	108	242	340	634	845	997	1,147	1,294	1,448	1,572	2,310	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	11,892	23,846	37,430	50,125	63,259	77,522	91,269	105,660	118,973	132,175	144,665	162,146	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	8,645	17,397	27,010	36,420	46,160	56,190	66,121	76,929	86,903	96,776	105,988	119,081	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,640	5,319	8,284	11,063	14,063	18,290	21,439	25,020	28,096	31,425	34,703	39,090	Health insurance
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	1,789	4,751	8,810	12,952	18,504	23,541	28,037	32,530	36,810	40,596	43,975	46,487	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,031	2,856	5,209	6,982	8,945	11,041	12,852	14,623	16,234	18,138	19,887.13	23,357	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	41	74	108	140	168	195	220	244	271	295	319	346	Unemployment insurance benefits
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca						0							Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	1,041	3,127	10,299	15,224	22,266	26,846	30,796	35,126	41,336	46,511	51,365	68,455	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	118	1,210	7,028	10,802	13,941	16,601	18,715	21,029	25,103	28,802	31,636	45,589	Domestically financing
2	Financimi Huaj	923	1,881	3,214	4,326	8,097	9,951	11,709	13,694	15,817	17,264	19,254	22,278	Foreign financed
IV	Detyrimet e prapambetura													Arrears
V.	DEFICITI	7,260	8,254	6,358	10,456	6,294	2,690	1,218	-107	-2,531	-3,508	-9,033	-31,012	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-7,260	-8,254	-6,358	-10,456	-6,294	-2,690	-1,218	107	2,531	3,508	9,033	31,012	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-7,789	-18,550	-15,508	-15,333	-13,022	-9,115	-7,720	-7,266	-14,675	-23,161	-20,089	1,899	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	4	24	123	283	289	347	355	366	373	402	410	418	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	7,474	8,681	11,187	11,815	13,517	14,238	13,022	12,750	13,740	16,135	16,203	16,285	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-15,266	-27,255	-26,818	-27,431	-26,829	-23,700	-21,098	-20,382	-28,787	-39,698	-36,703	-14,804	Others
V.3	I huaj	529	10,296	9,150	4,877	6,728	6,425	6,502	7,373	17,206	26,669	29,123	29,113	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	1,473	2,185	2,924	5,667	9,456	10,950	13,335	14,877	16,678	18,097	20,729	23,407	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nën-hua	391	768	1,128	1,937	2,697	3,628	4,548	5,427	6,129	6,485	7,005	8,208	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-312	-144	41	-1,298	-1,399	-923	-1,065	-701	-234	-134	588	169	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-811	-1,793	-3,863	-9,540	-11,376	-13,650	-16,525	-17,561	-18,771	-22,114	-23,500	-25,769	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	178	10,048	10,048	10,048	10,048	10,048	10,758	10,758	19,533	30,820	31,306	31,306	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

Chang. of stat. Account stands for the change in Foreign Financing Deposit

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

Tabela e investimeve 2017

Table of investments 2017

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	December	
Financim i brendshëm	118	1,246	7,086	10,898	14,169	16,601	18,714	21,028	25,103	28,801	31,636	45,589	Domestic financing
Në %	9.41	39.85	68.80	71.58	63.64	62.52	61.51	60.56	61.35	62.52	62.17	67.17	In %
Financim i huaj	1,136	1,881	3,214	4,326	8,097	9,951	11,709	13,694	15,817	17,264	19,254	22,278	Foreign financing
Në %	90.59	60.15	31.20	28.42	36.36	37.48	38.49	39.44	38.65	37.48	37.83	32.83	In %
Totali	1,254	3,127	10,300	15,224	22,266	26,552	30,423	34,722	40,920	46,065	50,889	67,867	Total
Në %	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6

TË ARDHURAT DOGANORE 2017

CUSTOMS REVENUES 2017

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
